

TAKIMI I 8-të RAJONAL I ILO-s

DELEGATËT SHQYROJNË PASOJAT SOCIALE DHE PASOJAT MBI PUNËSIMIN TË KRIZËS FINANCIARE

LISBONË (Lajme nga ILO) – Takimi i 8-të Rajonal i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) fillon punimet e tij këtë të Martë, duke u përballur me sfidën e formulimit të një përgjigjeje “Punë e Denjë” përkundrejt krizës financiare dhe ekonomike dhe për të trajtuar çështjen e humbjes së vendeve të punës dhe varfërisë sociale.

“Ne jemi duke përjetuar një përkeqësim dramatik të rezultateve dhe niveleve të punësimit në të gjithë rajonin”, tha Drejtori i Përgjithshëm i ILO-s, Z. Juan Somavia. “Jehonat sociale dhe politike të recesionit të thellë dhe të zgjatur janë të tmerrshme. Vëmendja jonë parësore duhet të përqëndrohet në ndalimin e zhytjes në një recesion social”.

Bazuar në një vlerësim të përditësuar mbi impaktin e krizës dhe politikat kundërvepruese, i përgatitur në prag të takimit, shenjat e krizës financiare dhe ekonomike mbi meshkujt dhe femrat në punë janë të dukshme në të 51 vendet e rajonit.¹

Vlerësimi i ri vë në dukje se kriza ka sjellë një ndryshim përsa i përket prirjeve zbritëse në nivelin e papunësisë të vërejtur në vendet e Evropës Jug-Lindore (që nuk janë anëtare të BE-së) dhe në shtetet anëtare të Bashkësisë së Shteteve të Pavarura (CIS) mbas vitit 2000.

Gjithashtu një studim i fundit i ILO-s mbi Tendencat Globale të Punësimit² vë në dukje se nëse rritja ekonomike ngadalësohet me ritme më të shpejta në vitin 2009 dhe përpjekjet për rekuperim vonohen deri në vitin 2010, rajoni i vendeve të Europës Jug-Lindore, që nuk janë anëtare të BE-së dhe vendet CIS mund të përjetojnë rritje të nivelit të papunësisë nga 8.8 për qind në vitin 2008, në 9.8 për qind në vitin 2009, ndërkohë që në Bashkimin Evropian dhe në vende të tjera me ekonomi të zhvilluar, niveli i papunësisë mund të rritet me 1.5 për qind, nga 6.4 për qind në vitin 2008, në 7.9 për qind në vitin 2009.

Qeveria, përfaqësuesit e punëmarrësve dhe punëdhënësve që marrin pjesë në këtë takim pritet të vlerësojnë paketa të ndryshme stimuluese që janë duke u zbatuar dhe të diskutojnë politika të përshtatshme ekonomike, punësimi dhe sociale me qëllim përfshirjen e Axhendës së Punës së Denjë, si një element kyç në politikat e kundërveprimit.

“Sot, kërkohen masa të guximshme dhe të shpejta për mbrojtjen e punëtorëve dhe familjeve më të ekspozuara dhe është e nevojshme të mbështetet kërkesa nëpërmjet investimeve dhe sipërmarrjeve. Qeveria, punëmarrësit dhe punëdhënësit do të përfitojnë nga ky takim për të krahasuar politika kundërveprimi dhe për të arritur konsensus në lidhje me rrugën më të mirë që duhet ndjekur”, tha Z. Somavia.

1 http://www.ilo.org/public/english/region/eurpro/geneva/download/events/lisbon2009/policy_responses_en.pdf.

2 http://www.ilo.org/global/What_we_do/Publications/lang--en/docName--WCMS_101461/index.htm

Ndërkohë që shumë nga debatet pritet të fokusohen mbi zgjidhjet afatshkurtra, perspektivat afatmesme për përmirësimin e punës së denjë në Evropë dhe Azinë Qendrore do të jenë po aq të dobishme. Në këtë drejtim, delegatët do të marrin gjithashtu në konsideratë pabarazitë globale, përfshirë këtu dhe rritjen e pabarazisë në të ardhura dhe ndryshimet në shpërndarjet rrogë/fitime, të cilat gjenden në qendër të situatës ekonomike aktuale.

Për këtë arsye delegatët do të shqyrtojnë një numër politikash punësimi dhe sociale, përfshirë këtu dhe politika për tregun e punës, dialogun social, politika për kordinimin e punës dhe familjes, mbrojtjes sociale, të drejtat themelore në punë dhe politika në lidhje me rrogat. Mbledhja pesë-ditore do të shërbejë gjithashtu si një platformë për rishikimin e punës së ILO-s që nga takimi i fundit rajonal i Budapestit i mbajtur katër vite më parë.

Vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore përballen me nivele të ndryshme ekspozimi ndaj krizës dhe i ndryshëm është gjithashtu dhe kapaciteti i tyre për t'u kundërpërgjigjur. Për shembull, balancat e llogarive rrjedhëse dhe fiskale variojnë në mënyrë të dukshme midis vendeve të ndryshme, sikurse ndodh edhe me nivelet e punësimit të periudhës para krizës si dhe me skemat e mbrojtjes sociale.

Ashtu si dhe në anë të tjera të botës, kriza goditi më parë shërbimet financiare dhe sektorët e ndërtimit të Evropës dhe Azisë Qendrore, për të kaluar në vijim në sektorët e shërbimeve dhe artizanatit, me pasojë zvogëlimin e porosive nëpërmjet zinxhirave të furnizimit dhe ushqimin e papunësinë.

ILO ka identifikuar një numër masash që nevojiten për mbrojtjen e njerëzve, mbështetjen e ndërmarrjeve prodhuese, ruajtjen e vendeve të punës dhe trajtimin e impaktit të krizës në ekonomitë reale, duke përfshirë:

- Vigjilencë më të madhe me qëllim garantimin e respektimit të plotë të parimeve themelore dhe të drejtave në punë, si liria e organizimit dhe e drejta për bisedime kolektive, eliminimi i të gjithë formave të punës së detyruar apo me forcë, zhdukja efektive e punës së fëmijëve, si dhe eliminimi i diskriminimit në fushën e punësimit dhe profesionit.
- Reflektim dhe konsultime nëpërmjet dialogut social mbi prioritetet dhe politikat për rikuperim.
- Konsideratë e veçantë duhet ti kushtohet zgjerimit të përfitimeve të papunësisë, lehtësimit të trajnimeve shtesë dhe mundësisë së ritrajnimit, forcimit të shërbimeve të punësimit duke zgjeruar apo ngritur skema punësimi për rastet e emergjencës, si dhe rrjeta të planifikuara sigurie.
- Zhvillimi dhe thellimi i masave të mbrojtjes sociale – sigurimet shoqërore dhe mbrojtja në punë – të qëndrueshme dhe të përshtatura me kushtet kombëtare, përfshirë këtu dhe mbrojtjen sociale për të gjithë.
- Ngritja e sistemeve të shëndosha të marrëdhënieve të punësimit të cilat do të kontribuojnë jo vetëm për shmangien e politikave që thellojnë pabarazitë globale apo rrisin pabarazitë në të ardhura por edhe në drejtim të rritjes ekonomike të balancuar.

“Vëmendja jonë duhet të kthehet në mbrojtjen e pjesëtarëve më të dobët të forcave të punës dhe ndërmarrjet e qëndrueshme – veçanërisht firmat e vogla – në mënyrë që ato të kenë akses në financimin e përshtatshëm, si dhe në përdorimin e plotë të institucioneve të dialogut social për zhvillimin e politikave që ju përgjigjen këtyre nevojave. Vendosja e Punës së Denjë në qendër të politikave ekonomike dhe sociale që i përgjigjen krizës do të hapë rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe më të balancuar në mënyrë që të përfitojnë të gjithë”, ka thënë Z. Somavia.

Shënim për korrespondentët: Për informacion të përgjithshëm mbi takimin ose për të kërkuar informacion apo kontakte të tjera, jeni të lutur të kontaktoni Departamentin e Komunikimit të ILO-s në numrin e telefonit +4122/799-7912 - communication@ilo.org, ose Zyrën e ILO-s në Lisbonë në numrin e telefonit +351 91 830 01 84, santosa@ilo.org

Për më shumë informacion mbi mbulimin, video, dokumenta dhe materiale të tjera për median, jeni të lutur të vizitoni:

http://www.ilo.org/global/About_the_ILO/Media_and_public_information/Press_releases/lang-en/WCMS_101587/index.htm